


Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit dhe Dinjitetit të Viktimave të Krimit të Gjenocidit dhe Parandalimit të këtij Krimi

Sot, më 9 dhjetor, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit dhe Dinjitetit të Viktimave të Krimit të Gjenocidit dhe Parandalimit të këtij Krimi, përkujtojmë të gjitha viktimat e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.

Kjo datë shërben si reflektim dhe kujtim për viktimat që humbën jetën, për shumë qytetarë të pafajshëm, përfshirë gra, fëmijë dhe të moshuar, shumë civilë që u torturuan dhe u trajtuan në mënyrë çnjerëzore, me elemente të qarta të krimeve kundër njerëzimit, të definuara sipas dokumentit të terminologjisë së standardizuar të IKKL-së.

Për të ilustruar këto krime kundër njerëzimit të kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), do t'i veçojmë disa masakra ku janë vrarë shumë pleq, gra e fëmijë. Të dhënat e paraqitura në këtë shkrim, mbështeten në materialet arkivore të Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë.

Një ndër këto krime që kanë lënë gjurmë në kujtesën tonë është **masakra e Mejës dhe Korenicës**, ku forcat serbe më 27 prill 1999 kanë vrarë e masakruar 376 civilë, prej të cilëve 4 ishin gra, me viktimen më të re Klaudia Malaj, 15 vjeç (*shih grafikun më poshtë*).




Grafikoni 1. Civilët e vrarë në masakrën e Mejës dhe Korenicës.

Sot kujtojmë edhe **masakrën e Carallukës**, ku forcat serbe, më 14 prill 1999, ekzekutuan 28 civilë, prej të cilëve 19 meshkuj dhe 9 femra, kurse prej të vrarëve 16 janë fëmijë të moshës 0–17 vjeç.


Sipas të dhënave të dokumentuara, shihet se nga gjithsej 28 viktima, më tronditëse është përbërja e moshës së fëmijëve, e cila përbën rreth 57% të totalit të të vrarëve në këtë masakër. Kjo përqindje

tregon se vrasja e të miturve nuk ishte e rastësishme, por pjesë e një veprimi të qëllimshëm ndaj popullatës civile (shih grafikun më poshtë).



Grafikoni 2. Civilët e vrarë në masakrën e Carallukës.


Një ngjarje tjetër në episodin e errët të krimeve ndaj popullatës civile ishte edhe **masakra e Kralanit**. Në këtë masakër, më 4 prill 1999, forcat serbe kanë vrarë **86** civilë, prej të cilëve 4 kanë qenë gra, dhe 82 burra, ndërsa fëmijë nga mosha 0 deri në 17 vjeç kanë qenë **7**, ndërkohë disa prej tyre ende rezultojnë të zhdukur (shih grafikun më poshtë).



Grafikoni 3. Civilët e vrarë në masakrën e Kralanit.

Masakra e Pokleikut, po ashtu njihet si një ndër masakrat më makabre që ka ndodhur gjatë luftës në Kosovë, ku forcat serbe më 17 prill 1999, vranë 53 civilë shqiptarë, prej të cilëve 19 burra dhe

34 gra. Prej viktimave, 24 kanë qenë nën moshën 18 vjeçare. Nga këto të dhëna shihet se shënjestër e kësaj masakre kanë qenë civilët e pambrojtur (*shih grafikun më poshtë*).



Grafikoni 4. Civilët e vrarë në masakrën e Poklekut.

Lufta në Kosovë gjatë vitit 1998-1999, përbën jo vetëm një tragjedi njerëzore me përmasa të jashtëzakonshme, por edhe një dëshmi të pakontestueshme të shkeljeve sistematike të të drejtave themelore të njeriut (*shih fotot më poshtë*).



Foto 1. Vrasja e fëmijëve shqiptarë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999 (Arkivi i Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë - IKKL).



Foto 2. Vrasja dhe dhunimi i grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë 1998-1999 (Arkivi i Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë - IKKL).



Foto 3. Masakra e Makovcit/Grashticës, Fotografia: 06 shtator 2000 (Arkivi i Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë - IKKL).



Foto 4. Shtëpia Muze - Masakra e Pokleikut (Arkivi i Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë - IKKL).



Foto 5. Masakra e Makovcit/Grashticës, 15 maj 1999 Arkivi i Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë - IKKL).

Duke kujtuar viktimat e pafajshme, duke u solidarizuar me familjet të cilat ende mbajnë plagët e humbjes së tyre, dhe me të mbijetuarit që mbartin barrën e dëshmisë historike, ne ndërtojmë një të ardhme ku dinjiteti njerëzor respektohet dhe ku asnjë njeri nuk duhet të përjetojë më mizori të tilla.

Ky dokumentim është përgatitur nga Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës (IKKL) si pjesë e projektit të dokumentimit sistematik të krimeve të luftës në Kosovë (1998-1999). Qëllimi i këtij dokumenti është ruajtja e kujtesës historike dhe kontributi në procesin e drejtësisë për viktimat e luftës.